



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E KULTURËS
Sektori për Rini dhe Sport

THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Prishtinës fton të gjitha OJQ-të të cilat implementojnë projekte rinore që të aplikojnë për financim. Projektet duhet të jenë në përputhje me planin e veprimit rinor lokal 2016-2018, të cilin e gjeni të bashkangjitur në ueb faqen e Komunës së Prishtinës dhe faqen zyrtare në facebook.

KRITERET

1. OJQ-të duhet të dëshmojnë se kanë implementuar projekte në të cilat kanë qenë të përfshirë moshat rinore;
2. Projekt propozimi duhet të jetë unik, d.m.th. nuk është implementuar në aktivitetet e mëparshme të këtij lloji;
3. Në kushte të barabarta, përparësi në përzgjedhje do të kenë projektet të cilat kanë për synim involvimin e të rinjve në viset rurale.
4. Përparësi në përzgjedhje do të kenë projektet që bazohen në shtyllat e politikave komunale për rini, të përfshira në Planin e Veprimit Rinor Lokal 2016-2018

Në këtë konkurs mund të aplikojnë edhe një grup organizatash së bashku për implementimin e një projekti të caktuar.

Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :

- Certifikata e numrit të regjistrimit të OJQ-ës;
- Certifikata e numrit fiskal të klubit/shoqatës;
- Letërnjoftimi i bartësit të xhirollogarisë;
- Vërtetimi / dëshmia e bankës në emër të OJQ-së
- Të dhënat e aplikuesit: telefoni , email adresa.

Projekt propozimet mund t'i dorëzoni nga data 18/11/2016 deri me datën 25/11/2016 në orën 15:00 në adresën: Komuna e Prishtinës (ndërtesa e vjetër), Zyra pritëse, Sporteli nr.5.

VËREJTE: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës dhe aplikuesit të cilët nuk kanë përmbyllur projektet nga edicionet e kaluara ndaj DK-së, nuk do të merren parasysh nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Për çdo paqartësi, sqarim apo pyetje eventuale mund t'i shkruani: Mevlude Zejnullut në e-mailin: mevlude.zejnullahu@rks-gov.net

Komuna e Prishtinës

Adresa: Rr.U Ç K Nr. 2, Prishtinë

Telefon-Faks; 038/230900

<http://www.kk.rks-gov.net/prishtinë>